

08.02.2022
Ora 16:40

RENDI I DITËS

Projektvendimi “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet e pjesshme për kryetar në bashkitë Shkodër, Dibër, Durrës, Vorë, Rrogozhinë dhe Lushnjë që do të zhvillohen më datë 6 Mars 2022”.

PJESËMARRJA :

KQZ:

• **Komisioni Rregullator:**

- | | | |
|------------|-------|----------------------------------|
| • Ilirjana | NANO | Kryetar |
| • Arens | ÇELA | Anëtar |
| • Dritan | ÇAKA | Anëtar |
| • Helga | VUKAJ | Anëtar |
| • Muharrem | ÇAKAJ | Anëtar |
| • Stafi | KQZ | Y.Merkaj,M.Koja,E.Meta,A.Tahiraj |

Parti Politike:

LSI (A. Kaziaj)

OJQ:

KRIK

Znj. I. Nano: Mirëmbërëma! Fillojmë mbledhjen e Komisionit Rregullator të njoftuar për ditën e sotme, e martë, 8 shkurt 2022. Njoftimi për mbledhjen është publikuar në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, gjithashtu u është përcjellë dhe partive politike, nëpërmjet përfaqësuesve të tyre në KQZ. Në mbledhje marrin pjesë të gjithë anëtarët e Komisionit Rregullator. Kemi përfaqësues të subjekteve zgjedhore, Sekretarin e Përgjithshëm Komisionit Qendror të Zgjedhjeve dhe zyrtarë të tjerë të administratës së Komisionit

Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.02.2022*

Qendror të Zgjedhjeve. Në rendin e ditës së mbledhjes së sotme kemi vetëm një pikë, shqyrtimin e projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 06 Mars 2022”. Sipas rregullores më lejoni të pyes fillimisht kolegët, anëtarët e Komisionit Rregullator dhe më tej dhe përfaqësuesit e e subjekteve zgjedhore të regjistruara për këto zgjedhje, nëse ka ndonjë çështje jashtë rendit të ditës për të diskutuar. Kolegë, zoti Kaziaj? Në rregull, nuk kemi çështje të tjera për diskutim jashtë rendit të ditës. Nisim me projektvendimin që kemi në rendin e ditës. Projektvendimi ka ardhur për shqyrtim në Komisionin Rregullator si propozim i Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve. Do t’i lutesha Sekretarit të Përgjithshëm të prezantonte projektvendimin, dhe më tej kalojmë në shqyrtimin e tij. Zoti Merkaj!

Z. Y. Merkaj: Referuar nenit 20, të ligjit të Kodit Zgjedhor, Komisioni Rregullator shqyrton dhe miraton projektaktet me karakter normativ, të përgatitur nga administrata e KQZ-së, udhëzues dhe doracakë në shërbim të administratës zgjedhore, subjekteve zgjedhore dhe zgjedhësve. Për këto arsye Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve ka përgatitur dhe po paraqet përpara Komisionit Rregullator, projektudhëzimin e punës së komisionit të qendrës së votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie në disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022. Ky udhëzues është një material ndihmës në ndihmë të komisionit të qendrës së votimit. Detyrat e komisionit të qendrës së votimit janë të përcaktuara në Kodin Zgjedhor dhe në akte të tjera nënligjore të dala në zbatim të Kodit. Në këtë udhëzim janë përmbledhur aspekte themelore të funksionimit dhe detyrat e komisionit të qendrës së votimit. Udhëzuesi është hartuar specifikisht për zgjedhjet e pjesshme vendore të datës 6 Mars 2022, dhe në udhëzues janë trajtuar çështje të natyrës së

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*




*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.02.2022*

përgjithshme dhe rregullat e etikës të zbatueshme në kushtet e pandemisë, përbërja e komisionit të qendrës së votimit, si dhe vakancat e mundshme, mbledhjet dhe vendimet e komisionit të qendrës së votimit dhe dokumentacioni që përdor komisioni i qendrës së votimit. Udhëzuesi ka trajtuar veprimtarinë e komisionit të qendrës së votimit një ditë para zgjedhjeve, konsiston në marrjen në dorëzim të materialeve zgjedhore dhe dërgimin dhe sigurinë e materialeve zgjedhore në qendrën e votimit. Në vijim udhëzuesi sqaron veprimtarinë e KQV-së në ditën e votimit duke përfshirë veprimet paraprake që nga hapja e votimit deri në përfundim të mbylljes së votimit. Ky udhëzues trajton periudhën e rregullt të votimit, por ka trajtuar dhe raste të veçanta, si rastet kur zgjedhësit ndihmohen nga një zgjedhës tjetër, ose zgjedhës të cilët nuk mund të shikojnë dhe zgjedhës që mund të votojnë me vendim gjykate. Në udhëzues trajtohen rastet që cenojnë procesin e votimit, si për shembull, zgjedhës që tentojnë votim të dyfishtë, votimi familjar apo zgjedhës që shënon votën jashtë dhomës së fshehtësisë apo fotografon votën. Bashkëlidhur keni projektvendimin për shqyrtim dhe miratim si dhe udhëzuesin e komisionit të qendrës së votimit, faleminderit!

Znj. I. Nano: Faleminderit zoti Merkaj! Pas prezantimit të projektaktit nga ana e Sekretarit të Përgjithshëm fillojmë me shqyrtimin e tij në parim, fillimisht nëse kolegët apo përfaqësuesit e subjekteve zgjedhore kanë diçka për të thënë lidhur me projektaktin. Unë do thoja në vijim të asaj që zoti Merkaj theksoi, që ky është një udhëzim i posaçëm për këto zgjedhje, pra, për zgjedhjet e pjesshme, të cilat nga ana tjetër janë vetëm zgjedhje për kryetar të bashkisë në 6 njësi të qeverisjes vendore. Dhe sigurisht është një instrument pune në duart e anëtarëve të komisioneve të qendrave të votimit, ku në mënyrë të detajuar nga një anë, por të përmbledhur nga ana tjetër, janë vendosur të gjitha detyrat e tyre, si para ditës së zgjedhjeve, ditën e zgjedhjeve, deri në momentin e mbylljes së

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.02.2022*

votimit, por edhe pas mbylljes së votimit, dhe gjithë proceset me radhë dhe të rregulluara në mënyrë të detajuar, çfarë duhet të bëjë kush, në raport me votimin gjatë datës 6 mars. Kolegë, nëse keni diçka në parim lidhur me projektvendimin? Zoti Kaziaj? Atëherë nëse nuk kemi diskutime në parim, kalojmë në votimin në parim, të projektvendimit “Për miratimin e udhëzuesit të punës për komisionet e qendrave të votimit, për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore, të datës 6 Mars 2022.

Kush është dakord?

Pro: 5 (zgj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S’ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në shqyrtimin e çdo pike. Projektvendimi ka 3 të tilla. Fillojmë me pikën e parë. Komisioni Rregullator vendosi:

1.Të miratojë udhëzuesin e punës për komisionet e qendrave të votimit për zgjedhjet e pjesshme vendore për kryetar bashkie, për disa njësi të qeverisjes vendore të datës 6 Mars 2022, bashkëlidhur këtij vendimi. Dhe pika 1 në fakt, përmbajtja e pikës 1, është gjithë udhëzuesi. Paraprakisht për administratën do të do doja të rishihnim këtë shprehje “për zgjedhjet e pjesshme vendore”. Në fakt zgjedhjet e pjesshme, koncepti i Kodit për zgjedhjet e pjesshme janë zgjedhjet vendore në çdo rast. Pra s’kemi nevojë, mendoj që ta theksojë “zgjedhje të pjesshme vendore”.

Z. M. Çakaj: Në fakt hartimi i këtij projektvendimi ka dhe një rirenditje të pikës 2 dhe pikës 3, sepse pika 2 duhet të ishte në fund, pra “kundër këtij vendimi, mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor, pranë Gjykatës së Apelit Administrativ Tiranë”. Pra ka ndryshuar dhe standardi që kemi, dhe në pikën 2 duhet të rivendoset fjalia “ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve”. Pra të kihet në konsideratë.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. I. Nano: Pra gjatë zbardhjes së vendimit...

Z. M. Çakaj: Po, të ndryshohet renditja, pika 3 kalon në pikën 2 dhe pika 2 kalon në pikën 3 dhe e riformuluar.

Znj. I. Nano: Mendoj që dhe kolegët për këtë rirenditje janë dakord, është për të mbajtur të njëjtin format të vendimeve. Pra hyrja në fuqi dhe më tej ankimi. Zoti Kaziaj!

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Unë kisha, përveç se ndaj propozimin e bërë nga ana juaj dhe nga zoti Çakaj. Tek pika 1 e vendimit që do merrni ju, tek pjesa e togfjalalëshit “për disa njësi të qeverisjes vendore”, ose të vihen bashkitë ose të hiqet fare ky togfjalësh, për shkak të unifikimit të praktikës në akte të mëparshme që ka miratuar ky komision.

Znj. I. Nano: Në fakt edhe unë e kam vënë re dhe këtë që sapo vuri në dukje zoti Kaziaj. Thjesht për një unifikim të vendimmarrjeve tona në këtë periudhë, për akte që janë posaçërisht për zgjedhjet në këto 6 bashki, edhe në titull edhe në trupin e aktit, thjesht referencat të jenë të 6 bashkitë. I kemi dhe në vendimet e tjera tonat. Pra këto nuk kanë të bëjnë me përmbajtjen e aktit, të cilin do të fillojmë ta diskutojmë tani, por janë disa sugjerime për ta përmirësuar, qoftë në titull dhe në përmbajtje nga këndvështrimi formal. Po, zonja Vukaj!

Znj. H. Vukaj: Edhe një shtesë tjetër. Nuk do ta konsideroja propozim se jam e bindur që administrata e ka në konsideratë sepse referencat dhe, le të them, transpozimin e ka bërë nga Kodi dhe nga dispozitat konkrete. Do doja që në preambulë, pra te baza ligjore të shtohet dhe baza ligjore konkrete, me qëllim që në zbatim ose në zbardhje të të gjithë pikave të udhëzuesit për paqartësi le t'i

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.02.2022*

referoheshin edhe Kodit, sepse siç e dimë, nuk kemi një kompaktësi të komisioneve në qendrat e votimit. Ato përfaqësojnë parti të ndryshme dhe subjekte të ndryshme zgjedhore. Kështu që do ishte në konsolidim të aktit mendoj, edhe shtesa e neneve specifike, të cilat referojnë të gjitha këto etapa dhe gjithë këtë procedurë, faleminderit!

Znj. I. Nano: Në rregull! Atëherë meqë jemi tek shqyrtimi i pikës 1. Pika 1 sikundër thamë, është udhëzimi bashkëlidhur. Unë nuk do të lexoj gjithë udhëzimin, por do të lexoj pjesë, pjesë, titujt e pjesëve apo të krerëve kryesorë të udhëzimit, në mënyrë që nëse do të kemi ndërhyrje konkrete, pra propozime për shtesa a ndryshime, por qoftë dhe saktësime, t'u referohemi pjesëve konkrete. Fillimisht ka një mesazh mirëseardhjeje, më tej udhëzuesi fillon me kreun 1.Rregullat e etikës. Kemi diçka për kreun 1? Jo!

Kalojmë tek i dyti. Rregullat në kushtet e pandemisë, covid.

Kreu 3. Përbërja e KQV-së dhe vakancat e mundshme. Do t'u lutesha kolegëve apo dhe përfaqësuesve të subjekteve zgjedhore, nëse kanë diçka, të kërkojnë fjalën.

Kreu 4. Detyrat e komisionit të qendrës së votimit.

Kreu 5. Mbledhjet dhe vendimet e KQV-së.

Kreu 6. Dokumentacioni i KQV-së dhe vulat.

Kreu 7. Veprimtaria e KQV-së një ditë para zgjedhjeve dhe këtu janë disa nënkrerë.

1. Marrja në dorëzim e materialeve zgjedhore dhe dokumenteve të tjera. Zoti Çaka, po!

Z. D. Çaka: Faleminderit kryetare! Tek pjesa 7, pika 1, "marrja në dorëzim e materialeve", thuhet kryetari dhe sekretari i komisionit të qendrës së votimit një ditë para datës së zgjedhjeve, jo më vonë se ora 15:00, terheq nga KZAZ-ja dhe

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



*Procesverbali i zbardhur i mbledhjes së
Komisionit Rregullator
Dt.08.02.2022*

jep dokumentacionin”. Ndërkohë tek pika b, themi, “ pajisjen elektronike të identifikimit, kamerën sipas udhëzimeve të posaçme të Komisionerit Shtetëror”. Po e bëj tani këtë, po themi parantezë, sepse në qoftë se do të shohim në vazhdim me pikën 2. Jo më falni!

Znj. I. Nano: Mendoj që duhet thjesht gjuhësisht të rregullohet!

Z. D. Çaka: Po, edhe nga pikëpamja gjuhësore.

Znj. I. Nano: “Pajisja dhe kamera administrohet”, se duket sikur edhe “pajisjen” e merr kryetari dhe sekretari. Pra, “pajisja”, jo “pajisjen”, “pajisja dhe kamera administrohen nga KQV”.

Z. D. Çaka: Ndërkohë, në qoftë se do të shkojmë tek gërma b, e pikës 2, thuhet “KQV nuk mund të largohet nga qendra e votimit nëse punonjësi përkatës i policisë nuk është paraqitur dhe njofton në KZAZ për mosparaqitjen e tij. Punonjësi i Policisë së Shtetit merr në ruajtje ambientin e qendrës së votimit, pasi komisioni i qendrës së votimit sjell materiale zgjedhore, PEI-in dhe kamerën për videoregjistrimin”. Ndërkohë tek pika 1, b, themi që “kjo do të jetë e përcaktuar me vendimmarrje të përbashkët të Komisionerit dhe Nënkomisionerit”. Ndërsa tek gërma b, e pikës 2, themi që “merr komisioni i qendrës së votimit PEI-in dhe kameran për ta dorëzuar”. Mos ka një përplasje të dispozitave, sepse nga njëra anë themi që ia kemi lënë Komisionerit këtë tagër, dhe nga ana tjetër themi që është komisioni i qendrës së votimit ai që bën dorëzimin e këtyre pajisjeve?

Znj. I. Nano: “Që i sjell këto materiale në KQV”.

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Z. E. Meta: Qëndron konstatimi juaj dhe do korrigojohet, për shkak të një gabimi material kam përshtypjen.

Z. D. Çaka: Kjo është pyetje me vend, domethënë. Cili do të jetë formulimi i... Pra do hiqet pjesa PEI dhe kamera nga pika 2, ku janë dërgimi i materialeve, gërma b.

Z. E. Meta: Do hiqet tek gërma b, e pikës 2, pjesa ku “komisioni i sjell materialet”, do hiqet fjala “PEI dhe kamera për regjistrimin”.

Z. D. Çaka: Po, sepse më sipër ne ketë ia kemi lënë të drejtë për ta vendosur edhe Komisioneri dhe Nënkomisioneri.

Znj. I. Nano: Në fakt gërma b, kuptimi i gërmës b, është tjetër gjë, por ndoshta ka një problem në formulim. Kuptimi, ose qëllimi i gërmës b, është fakti që punonjësi i policisë duhet të jetë atje mbasi kanë ardhur të gjitha materialet zgjedhore. Çështja se kush i sjell, është komisioni i qendrës së votimit apo operatorët, ose nuk e di si do ta vlerësojë Komisioneri, nuk ka rëndësi. Pra, ose mund të thuhet, një mënyrë e të shprehurit, dhe këtë e vlerësojmë. “Pasi materialet zgjedhore PEI dhe kamera për videoregjistrim të kenë ardhur në qendrën e votimit”. Pra ideja është që punonjësi i policisë do duhet të jetë atje pasi të gjitha të kenë ardhur. Ç’rëndësi ka kush i ka sjellë, kush ka detyrën për t’i sjellë. Pra, nëse mendojmë që mund të bëjmë një rivlerësim të tillë? Pra le të ndajmë qëllimin e shkronjës b, nga mënyra e formulimit.

Z. D. Çaka: Ne mund ta bëjmë dhe në këtë format. Tek fjalia e dytë, “punonjësi i Policisë së Shtetit merr në ruajtje ambientin e qendrës së votimit, pas ardhjes së materialeve zgjedhore në të”. Dhe nuk përcaktojmë as kush i sjell dhe as...

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



Znj. I. Nano: Po pra, kush i sjell sepse, që ato do të shkojnë në qendrën e votimit, materialet zgjedhore, PEI, kamera do shkojnë një ditë përpara.

Znj. H. Vukaj: Ndoshta draftshkruesit janë imponuar nga pika, nga titulli i pikës “dërgimi i materialeve zgjedhore në qendrën e votimit” dhe ndaj e kanë stërholluar pak fjalinë. Pra, është një nëntitull që nuk ka të bëjë posaçërisht me punonjës in e policisë.

Z. D. Çaka: Në qoftë se ne do ta lëmë këtë dispozitë, kështu që i bie që është komisioni i qendrës së votimit, ne e përcaktojmë këtu që është komisioni i qendrës së votimit, ai që do çojë PEI-n dhe kamerën në QV. Dhe nuk do këtë më vlerë dispozita e mësipërme, akti konkret i Komisionerit dhe Nënkomisionerit. Pra ne mund ta themi atë që “punonjësi i Policisë së Shtetit merr në ruajtje ambientin e qendrës së votimit, pasi të kenë ardhur materialet zgjedhore, PEI dhe kamera”. Pra, të heqim pjesën që “pasi komisioni i qendrës së votimit i sjell”, mbasi kanë ardhur.

Z. M. Çakaj: Mos ta bëjmë shumë të mistershme. Në qendrën e votimit PEI-n dhe kamerën me shumë gjasë do ta cojnë anëtarët e KQV-së. Nuk diskutohet kjo. Tani për të qenë fleksibël, për shembull, në zgjedhjet e kaluara, këtë detyrë ne ia ngarkuam operatorit, dhe pati probleme në pjesën e administrimit. Pati në disa raste mungesë përgjegjësie. Me shumë gjasë këtë detyrë ne do ia ngarkojmë operatorit, që do të thotë, do ua ngarkojmë anëtarëve të komisionit të qendrës së votimit. Që do të thotë ata janë personat përgjegjës, kryetari apo nënkryetari, sekretari, pra dy persona me parti të kundërt do ta marrin në dorëzim dhe do kenë dhe përgjegjësinë për këto. Në rastin konkret, dukshëm ka një përplasje midis asaj që tha kolegu Çaka. Në pikën b dhe në shkronjën b, të pikës 2. Pra, fjalia e dytë, që nga fjala, “pasi komisioni i qendrës së votimit sjell

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*



materialet zgjedhore”, deri këtu është në rregull. Pastaj PEI-n dhe kamerën për videoregjistrim, kjo ishte, del nga konteksti çfarë ka dashur të thotë administrata, ose çfarë duam ne të miratojmë. Konteksti është se çfarë veprime, ose deri në cilin moment është e detyruar komisioni i qendrës së votimit të rrijë aty. Pra, është ndjenjë përgjegjësie deri në momentin që vjen punonjësi i Policisë së Shtetit. Pra, ka të bëjë posaçërisht me rastet kur vonohet punonjësi i policisë. Kështu që unë mendoj që ta heqim që këtu dhe jemi në rregull. Ta ketë në konsideratë gjykata që ta heqë këtë. Pra, dy fjalët e fundit “PEI-n dhe kameran” për videoregjistrim dhe përfshihet tek materialet zgjedhore pastaj me bashkëudhëzim Komisioneri me Nënkomisionerin e bëjnë më fleksibël atë.

Znj. I. Nano: Në rregull! Pra edhe ky nuk është propozim për ndryshim, por thjesht një riformulim. Zoti Kaziaj!

Z.A.Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Jo thjesht për të sjellë në vëmendje faktin që duke lidhur dhe me sa tha zoti Çakaj, që në qoftë se është ndërmarrë një akt nga ana juaj në zgjedhjet e e shkuara për Kuvendin, dhe ky akt përmban në vetvete specificitetet e zgjedhjeve vetëm për zgjedhjet për Kuvendin. Mos duhet më mirë të ndryshojmë dispozitat e këtij akti? Ose riformulim të dispozitave të atij për të qenë më të saktë në vetvete?

Znj. I. Nano: Në fakt në aktin që ne kemi miratuar, për ngritjen, organizimin dhe funksionimin të komisioneve të qendrave të votimit, është vendimi 11, i vitit 2021. Norma që ne kemi miratuar ka parasysh atë që u tha më herët. Pra, ne kemi autorizuar Komisionerin dhe Nënkomisioneren për të miratuar me udhëzim të posaçëm pjesën e administrimit të PEI-t, dhe Komisionerin me kamera. Pra, janë pika 18, 19, e vendimit 11 të vitit 2021. Pra, ajo si normë

është. Me këtë rast ne ripërsërisim edhe njëherë që veprimet operationale i kryejnë Komisioneri dhe Nënkomisionerja përsa i përket PEI-t.

Z. A. Kaziaj, përfaqësues i LSI-së: Po në rast përplasje përgjegjësish, mos kemi konflikt personash?

Znj. I. Nano: Jo, ne mendojmë që është e qartë! Ne u themi Komisionerit, Nënkomisioneres, pra është thënë që në aktin e 2021, vendimi 11 që do të nxjerrim udhëzime operationale. Edhe këtu, edhe në tekst e kemi përmendur edhe më herët. Ja do të vijë momenti. Atëherë kemi pjesën 8 të udhëzimit. Veprimtaria e KQV-së në ditën e votimit. Edhe kjo pjesë ka disa, ose ky kre ka disa nënkrerë.

1. Veprimet paraprake të KQV-së në ditën e votimit.
2. Veprimet paraprake të KQV-së për hapjen e votimit.
3. Procedura e votimit.
4. Veprimet e KQV kur PEI nuk punon.
5. Mbyllja e votimit.
6. Veprimet pas mbylljes së votimit.

Këta janë 6 nënkrerët e kreut 8. Kemi diçka kolegë, apo të kalojmë tek kreu 9? Kreu 9. Rregulla në qendrën e votimit.

Kreu 10. Raste të veçanta votimi.

Kreu 11. Veprimet që cenojnë procesin e votimit.

Dhe këtu mbaron në mënyrë narrative, po themi, udhëzuesi. Në fund të projektudhëzuesit, i cili është pika 1 e projektvendimit, përmbajtja e tij, kemi dhe skemën orientuese të KQV. Pra, mënyrën e vendosjes së objekteve në komisionin e qendrës së votimit. Atëherë, me sa u pa nga shqyrtimi i pikës 1, nuk kishte propozime për shtesa apo ndryshime, por vetëm saktësime të vogla

Me 5 vota pro, miratohet!

Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Kolegjin Zgjedhor Gjyqësor pranë Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë, brenda 5 ditëve nga shpallja e tij.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Kalojmë në votimin në tërësi të projektvendimit. Edhe njëherë kolegë dakordësinë tuaj me projektvendimin në tërësi.

Kush është dakord?

Pro: 5 (znj.Nano, z.Çela, z.Çaka, znj.Vukaj, z.Çakaj)

Kundra: S'ka

Me 5 vota pro, miratohet!

Dhe njëherë gjatë zbardhjes administrata, po edhe në konsultim me anëtarët e Komisionit Rregullator, por dhe me procesverbalin e mbledhjes të reflektojë ato sugjerime për saktësime. Duke qenë që nuk kemi një çështje tjetër në rendin e ditës mbledhjen e deklaroj të mbyllur, faleminderit!

Vendimi nr. 15

*Zbardhi materialin audio
Lorena KONJA*

